

UDHËZIM
Nr. 8, datë 8.4.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
DHËNIEN E MEDALJES SË ARTË NXËNËSVE TË SHKËLQYER NË VITE,
PAS PËRFUNDIMIT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU 1
KRITERET PËR PËRFITIMIN E MEDALJES SË ARTË

1. Nxënësit të shkëlqyer ndër vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, i jepet “Medalje e artë”, nëse plotëson njëherësh kriteret e mëposhtme:

- a) Ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00.
- b) Në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të Maturës Shtetërore (MSH) është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.50.
- c) Në provimin kombëtar me zgjedhje të MSH-së është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 10.00.
- d) Ka vlerësimin në sjellje “Shumë mirë”, në gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë.

2. Nderohet me “Medalje e artë” nxënësi që është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, sipas rregullores “Për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrja e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare”.

KREU 2
PROCEDURA PËR DHËNIEN E “MEDALJES SË ARTË”

1. Në javën e parë të vitit shkollor institucionet arsimore parauniversitare përgatitin dhe dërgojnë në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), listat dhe dosjet e nxënësve që plotësojnë kriteret për “Medalje e artë”, sipas kreut 1 të këtij udhëzimi.

2. Dosja e nxënësit përmban dokumentet e mëposhtme:

- a) fotokopjen e kartës së identitetit;
- b) fotokopjen e diplomës dhe certifikatës së MSH-së;
- c) vlerësimin për sjelljen, për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë, lëshuar nga drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar;
- d) fotokopjen të certifikatës që nxënësi ka fituar, sipas pikës 2, të kreut 1 të këtij udhëzimi nëse ai e disponon.

3. ZVAP-të nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP), përcjellin brenda një jave listat dhe dosjet e nxënësve në Drejtorinë e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP).

4. DPAP-ja dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), listën e nxënësve të propozuar për “Medalje e artë”, e cila pasi kryen verifikimet për secilin nxënë lidhur me notën mesatare të shkollës së mesme, notën e shkallëzuar të provimeve të detyruara dhe të provimit me zgjedhje, si dhe certifikatën që nxënësi ka fituar në olimpiadën ndërkombëtare, e përcjell atë brenda një jave në DPAP.

5. DPAP-ja përcjell në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), dosjet e nxënësve së bashku me listën e verifikuar nga QSHA.

6. MASR-ja, pasi bën verifikimin përfundimtar të dosjes për secilin nxënës, sipas kriterëve dhe procedurave të këtij udhëzimi, përcjell në Kryeministri listën e nxënësve që u jepet “Medalje e artë”, të shoqëruar me projekturdhrin dhe relacionin shoqërues.

KREU 3

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. MASR-ja ka detyrimin të prodhojë “Medalje e artë” për të gjithë nxënësit që i përfitojnë ato.

2. Nxënësi, i cili pajiset me “Medalje e artë”, nuk ka përfitime të tjera financiare.

3. MASR-ja mban në një regjistër të veçantë të dhënat e nxënësve, të cilët janë pajisur me medaljen e artë.

4. Udhëzimi nr. 21, datë 2.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e ‘Medaljes së artë’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi